



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:256742

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05654375

**PKR.nr.13/2024**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda**, Trupi gjykues i përbërë nga gjyqtari Fatos Sejdiqaj-Kryetar i trupit gjykues, dhe anëtarët e trupit gjykues-Gjyqtarët : Mentor Hajraj dhe Mersiha Callakovic-Pllana, me zyrtarin ligjor Bardh Sylejmani, në çështjen penale ndaj të akuzuarve : N.M. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale – Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave piskotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të Kodit Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje:KPRK), rikualifikuar nga Gjykata në veprë penale-Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të Kodit Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje:KPRK) dhe D.J. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale–Posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave piskotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje:KPRK), akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.154/2023, të datës 21.02.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor me datë 03.04.2024, e cila ka qenë e hapur për publikun, në të cilën kanë prezantuar Prokurorja e shtetit Fetije Bajrami, i akuzuari N.M., Mbrojtësi i tij me autorizim me shkrim Av.Gani Hoxha si dhe i akuzuari D.J., me datë 04.04.2024 ka shpallur publikisht, ndërsa me datën 03.05.2024, e ka përpiluar me shkrim këtë :

### A K T G J Y K I M

- I -

**- Kundër të akuzuarit :**

**1.N.M.**, nga babai ..... dhe nëna ....., i lindur me datë ..... në Mitrovicë, me adresë Rr.”.....” Nr....., me numër personal ....., serb, Shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike.

**- ËSHTË FAJTOR -**

**-SEPSE :** Me datën 23.11.2023 rreth orës 03:30 minuta, i pandehuri në Mitrovicë në rrugën “Kral Petri” gjegjësisht te udhëkryqi për Zveqan saktësisht tek pompa e derivateve “Nis Petroll”, pa autorizim ka poseduar substanca narkotike të cilat me ligj janë shpallur si narkotik, ashtu që i pandehuri me automjetin VW Golf me targa GM -039-GK ka shëtitur nëpër rrugën e cekurë më lartë, ku policia ju kanë vënë pas dhe i ka dhënë shenjë që të ndalet, por i pandehuri nuk e ka ndaluar automjetin, ashtu që njësi patrulluese e policisë ka arritur t’i ndaloj, dhe në automjet policët kanë ndier aromën e substancave të dyshuara narkotike dhe gjatë kontrollës i pandehuri N.M. i cili ishte duke drejtuar automjetin, ka hedhur nga prapa në rrugë, një qese me sasi të dyshuar të kokainës e cila pas matjes ka rezultuar me peshë 10 gram, ndërsa gjatë kontrolles së automjetit nën ulësen e shoferit nga njësi patrulluese është gjetur edhe një qese me sasi të dyshuar e marihuanes në peshë prej 98 gram, ku pas marrjes se Ekspertizës së narkotikëve ka rezultuar se sipas dëshmisë D#1 përmbanë kokainë, pesha neto 9,95 gram ndërsa, dëshmia D#2 ka treguar se është prezent kanabisi-marihuanë, pesha neto 86,36.000.1gram.

**- Me këtë ka kryer veprën penale – Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).**

- Andaj, Gjykata në mbështetje të nenit 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42, 43, 69, 71 par.1 pika 1.3, 72 par.1 pika 1.5 dhe neni 269 par.1 të KPRK-së, lidhur me nenin 364, 449, 450 dhe 452 të KPP-së, të akuzuarin e:

### **- G J Y K O N -**

**I.-** Me Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë dhe Dënim me Gjobë në lartësi prej pesëqind (500.00) euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditëve, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë. Të akuzuarit në bazë të nenit 79 të KPRK-së në dënimin me burgim, i llogaritet edhe koha e kaluar nën masën paraburgimit nga data 23.11.2023 deri më datë 04.04.2024.

**II.-** Nëse i akuzuari dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e përcaktuar nga Gjykata, atëherë dënimin e shqiptuar me gjobë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së do të ia zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që një (1) ditë burgim do të i llogaritet me njëzetë (20.00) Euro gjobë.

**III.-** Të akuzuarit i ndërpritet masa e paraburgimit me datën 04.04.2024.

**IV.-** Gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 269 par.3 të KPRK-së lidhur me nenin 276 par.1 të KPP-së, urdhëron konfiskimin e përhershëm të substancës narkotike-të llojit kokainë me peshë neto prej  $9.95 \pm 0.0001$  gram si dhe e llojit kanabis (marihuanë) me peshë neto prej  $86.36$  gram  $\pm 0.0001$  gram, e që pasi aktgjykimi të bëhet i formës se prerë, narkotiku të shkatërrohet nga Policia e

Kosovës. Autorizohet Policia e Kosovës që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të bëjë asgjësimin e substancës narkotike.

**V.- URDHËROHET** Lirimi i automjetit VW i markës Golf –IV-, me targa ....., me numër identifikues të shasisë ....., Libreza e qarkullimit, si dhe kthimi i të hollave të të akuzuarit, paratë kesh në shumën e përgjithshme në lartësi prej tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e katërdhjetë (83.540) Dinar të Serbisë dhe paratë kesh në shumën e përgjithshme në lartësi prej dyqind e pesë (205.00) Euro.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar, urdhërohet të zbatojë këtë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**VI.- URDHËROHET** kthimi i telefonave mobil të akuzuarit, të markës : “Huawei Honor” me numër imei ..... dhe Samsung me numër imei ..... Prokuroria Themelore në Mitrovicë- Departamenti për Krime të Rënda në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, urdhërohet të zbatojë këtë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**VII.-** Obligohet i akuzuari që t`i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë shumën prej njëqind e pesëdhjetë (150) euro, në emër të paushallit gjyqësor shumën në lartësi prej njëzet (20) euro, dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**VIII.-** Kërkesë pasurore – juridike nuk kishte.

**- II -**

**- Kundër të akuzuarit :**

**2.D.J.**, nga babai ..... dhe nëna ....., mbiemri i vajzërisë ....., i lindur me datë ..... në Mitrovicë, ku dhe tani jeton Rr.”.....” Nr....., me numër personal të letërnjoftimit .....- lëshuar nga autoritetet e Serbisë, serb, Shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike.

Në bazë të nenit 362, paragrafi 1, nënpar.1.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje: KPP) :

**- REFUZOHET AKUZA -**

- **SEPSE** : Nga data e pavërtetuar e tutje i pandehuri në shtëpinë e tij që gjindet në rrugën “Cika Jovina” Mitrovicë-Veri, pa autorizim ka poseduar narkotik, substancat psikotrope apo analoge të cilat me ligj janë shpallur si narkotikë, ashtu që pas ekzaminimit të telefonit të pandehurit shihet i pandehuri me disa fotografi me sasi të ndryshme të narkotikëve duke i mbajtur në duar.

- **Me këtë kishte për të kryer veprën penale-Posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave piskotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPPK-së.**

- Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

- Kërkesë pasurore – juridike nuk kishte.

### **A r s y e t i m i**

#### **- Rrjedha e procedurës -**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.154/2023 të datës 21.02.2024, kundër të akuzuarve : N.M. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale – Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave piskotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së dhe D.J. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale– Posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave piskotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Seanca e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale është mbajtur me datë 03.04.2024, në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit Fetije Bajrami, i akuzuari N.M., Mbrojtësi i tij me autorizim Av.Gani Hoxha si dhe i akuzuari D.J.. Ky shqyrtim gjyqësor ka qenë i hapur për publikun.

Gjykata në kuptim të nenit 319 të KPP-së, të akuzuarin e parë dhe të dytë në shqyrtim gjyqësor i ka njoftuar me të drejtat e tyre në cilësinë e palës së akuzuar.

I akuzuari i parë-N.M. ka deklaruar se i ka kuptuar udhëzimet nga Gjykata dhe të drejtat e tij, ndërsa për mbrojtës sipas autorizimit e ka autorizuar Av.Gani Hoxha.

I akuzuari i dytë-D.J. ka deklaruar se i ka kuptuar udhëzimet nga Gjykata dhe të drejtat e tij, ndërsa për mbrojtës ka deklaruar se nuk dëshiron të angazhojë por do të vazhdojë vetë.

I akuzuari i parë ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë ashtu siç është cilësuar nga ana e prokurorisë, mirëpo ashtu si në shqyrtimin fillestar e pranoj fajësinë vetëm sa i përket posedimit të narkotikëve.

I akuzuari i dytë ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

Trupi gjykues e ka shpallur publikisht aktgjykimin me datë 04.04.2024, në prezencën e Mbrojtësit të të akuzuarit të parë, Av.Gani Hoxha.

**- Administrimi i provave në shqyrtim gjyqësor -**

Në këtë çështje penale, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 03.04.2024, janë administruar provat materiale si: Raportet e Policisë së Kosovës-Stacioni Policor në Mitrovicë-Veri Nr.2023-SA-RO-347 Rr.B.K. dhe A.B. Nr.R-23023-MIV-19, të datës 23.11.2023, Përmbajtja e dosjes së bashku me Raportin e vendit e ngjarjes i datës 23.11.2023, me listën e dëshmimeve dhe fotoalbumin e vendit të ngjarjes prej njëzetë e katër (24) faqe, Procesverbalet e marrjes në pyetje të të pandehurve në Policinë e Kosovës-Stacioni Policor në Mitrovicë-Veri datë 23.11.2023, Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 23.11.2023 për të pandehurit, Raporti i ekspertimit të narkotikëve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë AKF/2023-3760/2023-3646, i datës 06.02.2024, Raporti i ekzaminimit të telefonave të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë AKF/2023-0497 i datës 05.01.2024 së bashku me CD-të tjera dhe transkriptin e bisedave ekzaminuar nga telefoni i të pandehurit të dytë, në formatin PDF, Foto dokumentacioni në shkresat e lëndës me gjithsej gjashtëdhjetë e dy (62) fotografi.

- Gjykata ka refuzuar propozimin e prokurores së shtetit dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 03.04.2024, që në këtë çështje penale në cilësinë e dëshmitarëve të dëgjohen zyrtaret policor Z.Z. dhe B.K., për shkak se ishte i paarsyetuar e për më tepër Gjykata ka gjetur se të njëjtit kanë dhënë raporte zyrtare me shkrim, të cilët në mënyrë të qartë, saktë, bindëse dhe të detajuar kanë përshkruar rrjedhën e ngjarjes për këtë rast penal, ashtu që ka vlerësuar se dëgjimi i tyre është i panevojshëm.

**- Fjala përfundimtare e palëve -**

- Prokurorja e shtetit në fjalën e saj përfundimtare të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 03.04.2024, deklaroi se : mbetet në tërësi pranë aktakuzës së ngritur ndaj të akuzuarit N.M. për veprën penale të cekur si në aktakuzë, se i pandehuri ka kryer veprën penale u vërtetua nga raportet policore të cilët kanë përshkruar ngjarjen në tërësi, me ç'rast nga i njëjti kanë gjetur 83.543 dinal dhe 205 euro, pastaj kanë gjetur substancën narkotike, e cila sipas ekspertizës së narkotikëve ka rezultuar se pesha prej 9.95 gram përmbanë kokainë ndërsa, pjesa tjetër me peshë prej 86.36 gram përmbanë kanabis, prandaj duke marrë parasysh të gjitha këto qëllimi i tij ka qenë shtija e paautorizuar e narkotikëve andaj, bazuar dhe në fotodokumentacionin në shkresat e lëndës, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve, vërtetohet se i akuzuari ka kryer këtë vepër penale si në aktakuzë. Gjykatës i ka propozuar që të akuzuarin ta shpallë fajtor për veprën penale si në aktakuzë dhe ta dënojë sipas ligjit ndërsa, me rastin e marrjes së vendimit ndaj tij të marrë parasysh si rrethanë rënduese peshën e veprës penale, sasinë dhe llojin e narkotikëve kokainë.

Prokurorja e shtetit po në këtë shqyrtim gjyqësor në fjalën përfundimtare, sa i përket të akuzuarit të dytë-D.J. deklaroi se, tërhiqet nga akuza ndaj tij me arsyetimin se nuk ka arritur të sigurojë ekspertizën

lidhur me llojin e substancës e cila është gjetur në duartë e tij pas ekzaminimit të telefonit nga i njëjti ngase, nga informata e Agjencisë së Forenzikës së Kosovës kjo ekspertizë nuk mund të kryhet.

- Mbrojtësi i të akuzuarit N.M., Av.Gani Hoxha në fjalën e tij përfundimtare, të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 03.04.2024, ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor me provat e administruara nuk u vërtetua me asnjë provë të vetme se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës së prokurorisë, por nga provat e administruara u vërtetua se i akuzuari ka konsumuar elementet e veprës penale nga neni 269 të KPRK-së e cila ka të bëjë me posedimin e narkotikëve, e që këtë i akuzuari e ka pranuar edhe në shqyrtim gjyqësor madje e ka pranuar në polici dhe prokurori andaj, i ka propozuar gjykatës që të rikualifikojë veprën penale nga neni 267 të KPRK-së në nenin 269 të KPRK-së sepse nuk ka asnjë provë për të mbështetur aktakuzën e prokurorisë, nuk ka dëshmitarë e as të dëmtuar, madje nuk ka asnjë provë materiale e as personale. Më tej ka theksuar që, nëse Gjykata rikualifikon veprën penale me arsyet si më lartë, të merrë parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë për të njëjtin, moshën e tij të re, pendimin e tij të thellë dhe premtimin që nuk do të kryejë vepra penale dhe se nuk do të arratiset. Po ashtu, Mbrojtësi i të akuzuarit në fund i ka propozuar gjykatës që veturën ....., pronë e tezës së të akuzuarit znj....., t'i kthehen pasi që nuk është vërejtuar se është mjet me të cilin është kryer vepra penale si dhe t'i kthehen të hollat e specifikuar si në vërtetimin mbi sekuestrimin e sendeve.

- I akuzuari N.M. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, duke shtuar se i vie keq për këtë, nuk do ta përsërisë më dhe se do të përgjigjem çdo herë që të jetë e nevojshme.

#### **- Provat materiale -**

- Nga Raporti policor i Policisë së Kosovës-Stacioni Policor në Mitrovicë-Veri Nr.2023-SA-RO-347 i datës 23.11.2023, përpiluar nga zyrtari policor Rr.B.K., u vërtetua se me datë 23.11.2023 në Mitrovicë, në Rr."Kral Petri", rreth orës 03:15, zyrtarët policor përfshirë këtu dhe zyrtarin Z.Z, gjatë patrullimit të rregulltë kanë vërejtur duke lëvizur veturën Golf-IV- ngjyrë hiri, me targa GM-039-GK, ku pas sinjalizimit me rotacion, është ndalur tek pika e derivateve Nis Petrol, në të cilën kanë qenë tre persona, dhe gjatë kontrollit i akuzuari N.M. i cili kishte qenë duke vozitur, nga dritarja kishte hedhur një qese të vogël nga mbrapa me substancë të dyshuar narkotike të llojit kokainë, më pas kanë arrestuar atë i cili kishte fyerë dhe ofenduar zyrtarët policor madje ka rezistuar arrestimin, pastaj kanë arrestuar D.J. dhe M.T. të cilët ishin me të në veturë. Zyrtarët policor kanë shoqëruar të akuzuarin N. dhe dy të tjerët D.J. dhe M.T. në zyrat e Policisë në Mitrovicë-Veri. Gjatë kontrollit të detajshëm të veturës në këtë stacion policor, zyrtarët policor brenda saj nën ulësen e vozitësit kanë gjetur dhe një qese të zeze më substancë të dyshuar narkotike të llojit marihuanë. Tutje, nga ky raport vërtetohet se nga i akuzuari N.

janë gjetur dhe 83.540 dinar të Serbisë dhe 205 euro, e më pas substanca narkotike dhe paratë janë sekuestruar nga të njëjtit, ku i dyshuari është intervistuar dhe ka pranuar se substanca narkotike është e tij dhe e ka për konsumim personal. Më pas, ishte njoftuar Njësi i DHTN-së në Mitrovicë-Veri, ku substanca narkotike është fotografuar dhe matur me peshë totale prej 10 gram kokainë dhe 98 gram marihunë. Një gjendje e këtillë faktike, vërtetohet dhe nga Raporti i Policisë së Kosovës-Stacioni Policor në Mitrovicë-Veri, Njësia DHTN-Veri Nr.R-23023-MIV-19 i datës 23.11.2023, përpiluar nga hetuesi policor A.B., të cilët kanë përshkruar rastin në tërësi sipas njoftimit të zyrtarëve policor cekurë si më lartë.

- Nga përmbajtja e dosjes së bashku me Raportin e vendit të ngjarjes si dhe fotoalbumin e vendit të ngjarjes gjithsej njëzetë e katër (24) faqe, u vërtetua se nga i akuzuari N.M. janë gjetur substanca narkotike e llojit kokainë me peshë 10 gram dhe 98 gram marihuanë, paratë-kartëmonedhat në vlerë 83.540 dinar dhe 205 euro, dy telefona të markës Honor dhe Samsung si dhe vetura Golf IV me targa GM-039-GK, ndërsa nga i akuzuari D.J. një telefon Iphone kurse, nga i dyshuari M.T., për të cilin kanë pushuar hetimet me aktvendim të veçantë të Prokurorisë së shtetit, i janë gjetur dy telefona Samsung, të cilat dëshmi më pas janë fotografuar.

- Nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 23.11.2023, u vërtetua se nga i akuzuari N.M. është sekuestruar përkohësisht, substanca e dyshuar narkotike e llojit kokainë me peshë rrethë 10 gram dhe substanca e dyshuar narkotike llojit marihuanë me peshë rreth 98 gram, pastaj dy telefona mobil të akuzuarit, të markës : “Huawei Honor” me numër imei ..... dhe Samsung me numër imei ..... si dhe vetura VW e markës Golf –IV- me targa ....., me numër identifikues të shasisë ....., të hollat-paratë kesh në shumën e përgjithshme në lartësi prej tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e katërdhjetë (83.540) Dinar të Serbisë dhe paratë kesh në shumën e përgjithshme në lartësi prej dyqind e pesë (205.00) Euro.

- Nga Raporti i ekspertimit të narkotikëve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, AKF/2023-3760/2023-3646 i datës 06.02.2024, u vërtetua se nga ekzaminimi i substancës Dëshmia D#1, sipas përbërjes kimike përmban kokainë me peshë neto prej  $9.95 \pm 0.0001$  gram ndërsa, nga ekzaminimi i substancës Dëshmia D#2 sipas karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike, përmban kanabis (marihuanë) me peshë neto prej  $86.36 \pm 0.0001$  gram.

- Nga Raporti i ekzaminimit të telefonave AKF/2023-0497 i datës 05.01.2024 së bashku me CD-në, lidhur me të akuzuarin N.M., u vërtetua se nga Dëshmia D#4-telefoni i markës Huawei Honor me numër imei 867638048046675 dhe Dëshmia D#5-telefoni i markës Samsung me numër imei

352953553782016, nuk ka mundur të ekzaminohen në mënyrë të avancuar dhe për shkak të konfigurimit, por që nga SIM kartelat e tyre kanë arritur të gjejnë tri kontakte.

- Meqenëse Prokurorja e shtetit, pas administrimit të provave materiale, gjegjësisht në fjalën përfundimtare në shqyrtimin gjyqësor të datës 03.04.2023, u tërheq nga akuza për të akuzuarin e dytë D.J., Gjykata nuk ka arsyetuar dhe dhënë sqarime për CD-në në raport me këtë të akuzuar dhe transkriptin e bisedave ekzaminuar nga telefoni i të njëjtit, si në shkresat e lëndës ofruar në formatin PDF.

- Nga foto dokumentacioni i shkresave të lëndës, shihen qeset me substancë narkotike, telefonat, parat kesh-kartëmonedhat në valutën dinar dhe euro si dhe vetura Golf IV, të cilat janë sekuestruar nga i akuzuari N.M..

#### **- Paraqitja e mbrojtjes nga i akuzuari -**

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 03.04.2024, i akuzuari pasi që është njoftuar edhe një herë me të drejtat e tij nga neni 319 të KPP-së, ka deklaruar se : Mbetet pranë deklaratës së dhënë në prokurori me datë 29.12.2023 dhe se substanca narkotike që i është gjetur me datë 23.11.2023 e ka pasur për konsum personal si atë kokainë po ashtu dhe marihuanë, të cilën e ka pasur në xhep, ndërsa arsyeja pse ka filluar konsumimin ka theksuar se është për shkak se babain e ka të sëmurë, sepse me parë babai i tij ka pësuar sulm në kokë dhe nuk ka ditur se si ta qetësojë vetën. Më tej ka theksuar se nuk e di ku e ka blerë e as sa kushton, në natën kritike ka theksuar se ka qenë në një kafe-aheng me shoqëri ndërsa, ka pohuar se momentin e arrestimit ka qenë me D.J. dhe M.T. kurse, sasinë e narkotikëve ka theksuar se nuk e ka ditur sa e kishte atë natë.

#### **- Faktet e vërtetuara nga Gjykata pas administrimit të provave -**

Pas administrimit të gjitha provave në shqyrtim gjyqësor dhe pas analizimit të tyre, Gjykata ka vërtetuar faktet si në vijim :

- Faktin se me datë 23.11.2023, rreth orës 03:30, i akuzuari N.M. ka poseduar substancë narkotike, ky fakt u vërtetua nga Raporti policor i Policisë së Kosovës-Stacioni Policor në Mitrovicë-Veri Nr.2023-SA-RO-347 i datës 23.11.2023, përpiluar nga zyrtari policor Rr.B.K, e po ashtu nuk është kundërshtuar nga i akuzuari në asnjë fazë të procedurës. Nga i njëjti raport policor, u vërtetua gjithashtu fakti se të akuzuarit nuk i është gjetur ndonjë peshore apo qese e zbrazët që do t'i shërbente për paketimin e substancës narkotike.

- Faktin se nga i akuzuari N.M. me datë 23.11.2023, pas kontrollit të tij i janë gjetur dhe sekuestruar substancat narkotike, dy telefona mobil për tu dërguar më pas në ekzaminim si dhe vetura e markës



Golf IV ngjyrë hiri, me targa GM-39-GK9 dhe libreza e qarkullimit, këto fakte janë vërtetuar me vërtetimin e sekuestrimit të përkohshëm të sendeve të datës 23.11.2023.

- Faktin se substanca narkotike e sekuestruar nga i akuzuari sipas karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike, është e llojit kokainë me peshë neto prej  $9.95 \pm 0.0001$  gram dhe kanabis (marihuanë) me peshë neto prej  $86.36 \pm 0.0001$  gram, është vërtetuar nga Raporti i ekspertimit të narkotikëve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, AKF/2023-3760/2023-3646 i datës 06.02.2024.

- Faktin se në shtëpinë e të akuzuarit nuk është kryer ndonjë kontroll, pasi që është gjetur substanca narkotike tek i akuzuari, ky fakt është vërtetuar pasi që në shkresat e lëndës nuk gjendet asnjë provë materiale me të cilën vërtetohet kontrolli i shtëpisë së të akuzuarit.

- Faktin se të akuzuarit i janë ekzaminuar telefonat mobil të markës Huawei Honor me numër imei ..... dhe Samsung me numër imei ..... dhe se të njëjtit nuk ka mundur të ekzaminohen në mënyrë të avancuar për shkak të konfigurimit, ky fakt u vërtetua nga Raporti i ekzaminimit të telefonave AKF/2023-0497 i datës 05.01.2024 së bashku me CD-në.

#### **- Vlerësimi i gjykatës në raport me provat e administruara -**

- Gjykata në mbështetje të nenit 360 të KPP-së, provat e administruara në shqyrtim gjyqësor i vlerësoi të gjitha një nga një dhe me rastin e përcaktimit të përgjegjësisë penale për të akuzuarin N.M., para se gjithash u bazua në provat si në vijim :

- Nga Raportet policore të Policisë së Kosovës-Stacioni Policor në Mitrovicë-Veri Nr.2023-SA-RO-347 dhe Njësia DHTN-Veri Nr.R-23023-MIV-19 të datës 23.11.2023, rrjedhë se me datë 23.11.2023 në Mitrovicë, në Rr."Kral Petri", rreth orës 03:30 min., tek pika e derivateve Nis Petrol zyrtarët policor gjatë patrullimit të rregulltë kanë ndalur të akuzuarin N.M. i cili ishte duke drejtuar veturën Golf-IV-ngjyrë hiri, me targa ....., ku së bashku me të ishin dhe i akuzuari D.J. dhe M.T., dhe të njëjtit i është gjetur substanca narkotike e llojit kokainë dhe kanabis (marihuanë), e më pas substanca narkotike, paratë, telefonat dhe vetura Golf IV, i janë sekuestruar të njëjtit.

Përveç kësaj, Gjykata me rastin e marrjes së vendimit i vlerësoi edhe provat materiale të cilat i ka administruar në shqyrtim gjyqësor, në rastin konkret vetëm provat materiale lidhur me të akuzuarin N.M., si : Përmbajtjen e dosjes së bashku me Raportin e vendit të ngjarjes si dhe fotoalbumin e vendit të ngjarjes gjithsej njëzetë e katër (24) faqe, Vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 23.11.2023, Raportin e ekspertimit të narkotikëve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, AKF/2023-3760/2023-3646 të datës 06.02.2024, Raportin e ekzaminimit të telefonave AKF/2023-0497 të datës 05.01.2024 së bashku me CD-në, si dhe Fotodokumentacionin në shkresat e lëndës.

- Gjykata me rastin e vendosjes si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua edhe në deklarinimin e të akuzuarit gjatë mbrojtjes së tij, pasi që i njehti në asnjë fazë të procedurës nuk e ka kontesuar faktin se me datë 23.11.2023 ka poseduar narkotikë, madje i njehti e ka pranuar fajësinë sa i përket posedimit të narkotikëve në seancën e shqyrtimit fillestar dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor, por nuk e ka pranuar fajësinë për veprën e kualifikuar penale nga prokuroria si në aktakuzë, andaj edhe Gjykata nuk ka mundur t'a pranojë fajësinë nga i pandehuri në atë fazë të procedurës kur edhe është bërë pranimi i fajësisë, pasi që për gjykatën ka qenë e domosdoshme të lëshohet në administrimin e provave në mënyrë që të vërtetohet se me veprimet e të akuzuarit janë përmbushur elementet e veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### **- Rikualifikimi i veprës penale -**

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë, e ka akuzuar të akuzuarin N.M., për veprën penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e prokurorisë në raport me përshkrimin faktik të ngjarjes, provave që janë deponuar nga palët dhe të administruara në shqyrtim gjyqësor, të gjitha këto nga Gjykata janë vlerësuar në raport me nenin 359 par.2 të KPP-së, sipas të cilit Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale.

- Gjykata, duke u mbështetur në faktet dhe provat të proceduara në shqyrtimin gjyqësor, ka vlerësuar se ne veprimet e të akuzuarit nuk përmbushën elementet e veprës penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës-Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së.

Sipas kësaj dispozite ligjore është përcaktuar se, kjo vepër penale kryhet kur : *“Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, në rastin konkret nga provat e administruara nuk është vërtetuar se i pandehuri narkotikun të cilin e ka poseduar ka pasur qëllim që ta shes apo shpërndajë, pasi që nuk është identifikuar ndonjë blerës i mundshëm, e po ashtu nga provat e administruara nuk kemi asnjë provë se nga i akuzuari është sekuestruar ndonjë peshore, gjë që do të dëshmonte se i akuzuari ka pasur qëllim të shes narkotikë dhe se nuk ka pasur ndonjë kontroll as në shtëpinë e të akuzuarit, andaj nga këto fakte Gjykata ka bërë rikualifikimin e veprës penale duke vlerësuar se ne veprimet e të akuzuarit N.M. përmbushen elementet e veprës penale-Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269, par.1 të KPRK-së, pasi që për këtë e kishte pranuar fajësinë se është përdorues i saj dhe substancën narkotike të gjetur në natën kritike e kishte për përdorim personal.*

- Për gjykatën nuk është kontestuese fakti se zyrtarët policor gjatë kontrollit të të akuzuarit N.M., kanë gjetur substencën narkotike të llojit kokainë dhe kanabis (marihuanë), pasi që kjo vërtetohet nga raportet policore të Policisë së Kosovës-Stacioni Policor në Mitrovicë-Veri të datës 23.11.2023, fakt të cilin nuk e ka kontestuar as i akuzuari në asnjë fazë të procedurës penale, mirëpo vetëm fakti se narkotiku ka qenë i ndarë-një pjesë të llojit kokainë dhe tjetra të llojit kanabis (marihuanë), nuk mund të vie në përfundim se i akuzuari ka pasur për qëllim që narkotikun ta shesë apo shpërndajë.

- Gjykata edhe njëherë konstaton se, pasi administrojë provat material në shqyrtim gjyqësor dhe pas vlerësimit të pretendimit të palëve, vërtetoi përtej çdo dyshimi se i akuzuari N.M., ka kryer veprën penale-Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 par.1 të KPRK-së, pasi që me datën 23.11.2023 rreth orës 03:30 minuta, i pandehuri në Mitrovicë në rrugën “Kral Petri” gjegjësisht te udhëkryqi për Zveqan saktësisht tek pompa e derivateve “Nis Petroll”, pa autorizim ka poseduar substanca narkotike të cilat me ligj janë shpallur si narkotik, ashtu që i pandehuri me automjetin VW Golf me targa GM -039-GK ka shetitur nëpër rrugën e cekurë më lartë, ku policia i janë vënë pas dhe i ka dhënë shenjë që të ndalet, por i pandehuri nuk e ka ndalur automjetin, ashtu që njësia patrulluese e policisë ka arritur t’i ndaloj, dhe në automjet policët kanë ndier aromën e substancave të dyshuara narkotike dhe gjatë kontrollës i pandehuri N.M. i cili ishte duke drejtuar automjetin, ka hedhur nga prapa në rrugë, një qese me sasi të dyshuar të kokainës e cila pas matjes ka rezultuar me peshë 10 gram, ndërsa gjatë kontrolles së automjetit nën ulësen e shoferit nga njësia patrulluese është gjetur edhe një qese me sasi të dyshuar e marihuanes në peshë prej 98 gram, ku pas marrjes se Ekspertizës së narkotikëve ka rezultuar se sipas dëshmisë D#1 përmbanë kokainë, pesha neto 9,95 gram ndërsa, dëshmia D#2 ka treguar se është prezent kanabisi-marihuanë, pesha neto 86,36.000.1 gram, për çka Gjykata gjeti se i njëjti në aspektin penal është përgjegjës dhe i shqiptojë dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

- Gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 359 par.2 të KPP-së, e cila dispozitë nuk e detyron gjykatën me propozimin e prokurorisë lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale, në këtë rast ka ndryshuar përshkrimin e gjendjes faktike në masën e lejueshme, për faktin se gjendja faktike në një rast drejtpërdrejt e determinon kualifikimin ligjor të veprës penale. Gjykata në përshkrimin faktik të aktgjykimit nuk ka ndryshuar përmbajtjen esenciale të akuzës në raport me kohën, vendin, të akuzuarin, përveç se ka ndryshuar gjendjen faktike në aspektin faktik ka ndryshuar edhe kualifikimin ligjor të veprës penale.

- Neni 359 par.2 i KPP-së, përcakton se : *“Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor ytë veprës”*.

**- Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit -**

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata kishte parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për veprën penale për të cilën i akuzuari N.M. është shpallur fajtor, pastaj kishte parasysh edhe qëllimin e dënimit dhe të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, që ndikojnë në ashpërsimin ose zbutjen e dënimit.

- Si rrethanë lehtësuese Gjykata gjeti, moshën e re të akuzuarit në kohën e kryerjes së veprës penale, pendimin e të akuzuarit për kryerjen e kësaj vepre penale, faktin se i njëjti në çdo fazë të procedurës penale e ka pohuar faktin se me datë 23.11.2023 ka poseduar narkotikë për konsumim personal, ndërsa si rrethanë rënduese Gjykata gjeti shkallën e rrezikshmërisë së kryerjes së kësaj vepre penale, pastaj faktin se një pjesë e substancës narkotike ishte e llojit kokainë e cila bënë pjesë në grupin e substancave më të rrezikshme në raport substancat tjera, pasojat e veprës penale të cilat do të mund t'i atakonin edhe personat tjerë të shoqërisë sidomos të rinjtë.

Në rastin konkret kundër këtij të akuzuari, Gjykata vendosi që të aplikojë dispozitat e zbutjes së dënimit duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 71 par.1 pika 1.3 të KPRK-se, në të cilën dispozitë ligjore parashihet se Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë ligjor apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit në rast kur kryesi pranon fajësinë. Në rastin konkret i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale të ri kualifikuar nga Gjykata, në të gjitha fazat e procedurës penale, andaj Gjykata të njëjtit i shqiptojë dënimin me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit nën minimumin e paraparë ligjor për këtë vepër penale.

Gjykata zbutjen e dënimit ndaj të akuzuarit e ka bërë në kuadër të kufijve për zbutjen e dënimit të paraparë në dispozitën ligjore nga neni 72 par.1, pika 1.5 të KPRK-së, në të cilën parashihet “nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënim me burgim prej së paku një (1) vjet, dënim mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim”. Në rastin konkret për veprën penale për të cilën i akuzuari N.M. është shpallur fajtor, për shkak të veprës penale-Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 par.1 të KPRK-së, është paraparë dënim me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

- Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se dënim i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale me të cilën akuzohet i akuzuari dhe se Gjykata ka vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllim i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, se i akuzuari në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e paligjshme dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, në parandalimin e

personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

**- Llogaritja e paraburgimit në dënimin e shqiptuar –**

- Vendimin për llogaritjen e kohës së kaluar nën masën e paraburgimit për të akuzuarin nga data 23.11.2023 deri më datë 04.04.2024 në dënimin e shqiptuar me burgim, Gjykata e mori duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 79 par.1 dhe par.4 të KPRK-së.

**- Ndërprerja e masës së paraburgimit –**

- Gjykata ka vendosur si në pikën I, nënpika - III- të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe ndaj të akuzuarit, e ka ndërprerë masën e paraburgimit në kuptim të nenit 366 par.1, nënpar.1.2 të KPP-së, dhe arsyet në lidhje me këtë i ka dhënë në Aktvendimin e veçantë PKR.nr.13/2023 datë 04.04.2023, për ndërprerjen e kësaj mase.

**- Vendimi për konfiskimin e substancave narkotike –**

- Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për konfiskimin e substancave narkotike të llojit kokainë me peshë neto prej  $9.95 \pm 0.0001$  gram si dhe atë të llojit kanabis (marihuanë) me peshë neto prej  $86.36 \text{ gram} \pm 0.0001 \text{ gram}$ , e që pasi aktgjykimi të bëhet i formës së prerë substancat narkotike të shkatërrohen nga Policia e Kosovës, bazuar në nenin 269 par.3 të KPP-së.

**- Vendimi për kthimin e pasurisë –**

- Gjykata në këtë çështje penale vendosi si në pikën -I-, nënpika -V- të dispozitivit të aktgjykimit ashtu që, Urdhëroi lirim të automjetit VW të markës Golf -IV-, me targa ....., me numër identifikues të shasisë ....., Librezën e qarkullimit-sipas së cilës pronë e ....., si dhe kthimin e të hollave të të akuzuarit, paratë kesh të valutës dinar : 1x5000, 23x2000, 25x1000, 11x500, 4x200, 10x100, 4x50, 2x20 në shumën e përgjithshme në lartësi prej tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e katërdhjetë (83.540) Dinar të Serbisë dhe paratë kesh të valutës euro : 1x50, 6x20, 3x10, 1x5 në shumën e përgjithshme në lartësi prej dyqind e pesë (205.00) Euro (kartëmonedha këto të pa evidentuara me numër serik), specifikuar si në Vërtetimin për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve datë 23.11.2023 dhe Raporti nga njësia e forenzikës datë 23.11.2023, pasi që në rastin konkret nga provat materiale administruar në shqyrtimin gjyqësor të datës 03.04.2024, Gjykata në kuptim të nenit 19 par.1, nënpar.1.37 dhe 1.38 të KPP-së, ka konstatuar se nuk janë pasuri të cilat janë përdorur apo kanë rezultuar me rastin e kryerjes së veprës penale, rikualifikuar nga Gjykata për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për çka dhe është urdhëruar Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar, të zbatojë këtë pas

plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa pronari i automjetit si më lartë është liruar nga të gjitha shpenzimet eventuale të shkaktuara lidhur me transportin, mbajtjen dhe mirëmbajtjen e sendit gjatë kohës nga sekuestrimi e deri të lirimi i tij.

Po ashtu, Gjykata vendosi si në pikën -I-, nënpika –VI- të dispozitivit të këtij aktgjykimi ashtu që, Urdhëroi kthimin e telefonave mobil të akuzuarit N.M., të markës : “Huawei Honor” me numër imei ..... dhe Samsung me numër imei ....., për të cilën është urdhëruar Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, të zbatojë këtë pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, pasi që nga provat materiale administruar në shqyrtimin gjyqësor të datës 03.04.2024 Gjykata në kuptim të nenit 19 par.1, nënpar.1.37 dhe 1.38 të KPP-së, edhe për këto pasuri-telefona ka konstatuar se nuk janë pasuri të cilat janë përdorur apo kanë rezultuar me rastin e kryerjes së veprës penale, rikualifikuar nga Gjykata për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### **- Refuzimi për pikën –II- të akuzës –**

- Në raport me të akuzuarin D.J., për shkak të veprës penale-Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, akuzuar sipas pikës –II- të dispozitivit të aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.154/2023 të datës 21.02.2024, Gjykata në kuptim të nenit 362 par.1, nënpar.1.1 të KPP-së, vendosi si në pikën –II- të dispozitivit të aktgjykimit, ashtu që refuzoi akuzën pasi që, Prokurorja e shtetit në shqyrtimin gjyqësor të datës 03.04.2023, është tërhequr nga akuza ndaj tij, me arsyetimin se nuk ka arritur të sigurojë ekspertizën lidhur me llojin e substancës e cila është gjetur në duart e këtij të akuzuari pas ekzaminimit të telefonit nga i njëjti.

#### **- Vendimi për shpenzimet e procedurës penale -**

- Lidhur me shpenzimet e procedurës penale, Gjykata vendimin për të akuzuarin N.M. e mori në bazë të nenit 450 dhe 452 të KPP-së, ndërsa vendimin për taksën në kompensimin e viktimave të krimit e mori në bazë të nenit 36 par.3, nënpar. 3.2 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit. Sa i përket vendimit për shpenzimet e procedurës penale në raport me të akuzuarin D.J., Gjykata e mori në mbështetje të nenit 453 par.1 të KPP-së dhe të njëjtat të paguhen nga mjetet buxhetore të Gjykatës.

#### **- Kërkesa pasurore juridike -**

Sipas aktakuzës palë të dëmtuar nuk kishte, andaj Gjykata për kërkesën pasurore juridike në këtë çështje penale nuk vendosi fare.

- Gjykata, nga arsyet e cekura si më lartë e bazuar në nenin 364 dhe nenin 362 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**Departamenti për Krime të Rënda**

**PKR.nr.13/2024, datë 03.05.2024.**

**Zyrtari ligjor**

**Bardh Sylejmani**

**Kryetari i trupit gjykues - Gjyqtari**

**Fatos Sejdijaj**

---

- **KËSHILLË JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.